



Npi – 01/81 datë: 30.04.2026

Duke u bazuar në nenin 44 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Shtimes e mbajtur më 30.04.2026, është nxjerrë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I Mbledhjes së -III- të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes,
e mbajtur më datën 30.04.2026 (e enjte), në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Rrahman Jakupi, Antarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Zenel Shabani, z.Artan Lubovci, z.Faruk Beqa, znj.Uskana Deliu, znj.Adelina Shabani, z.Asllan Beqaj z.Demokrat Mujota, z.Faik Ramadani, znj.Albana Podvorica, znj.Fatlinda Rrafshi, znj.Arbresha Sylja, z.Bajram Hajrizi, z.Haqif Arifi, z.Shefqet Krasniqi, znj.Frosina Berisha-Ahmeti, znj.Erza Salija, z.Atdhe Isufi, z.Muhamet Ademaj. Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe Nënkryetari, z.Adnan Ademi, Drejtorat e DBF, z.Besnik Ahmeti, DPP, z.Valon Januzi, DZHE, z.Grejtalb Emini, DSHMS, znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, pastaj zyrtarë i IT-së z.Shpëtim Gashi, Praktikantët, z.Albion Shabani, znj.Hava Llugaxhija, znj.Admire Selmani, znj.Teuta Mustafa, znj.Valmira Behluli dhe znj.Agnesa Ademaj.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Përshëndetje. Para se të hapi mbledhjen e tretë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Shtimes më lejoni që të ndajmë dhimbjen për kolegen tonë, anëtarën e Kuvendit, znj. Yllkë Fejzullahu dhe në shenjë nderimi ju ftoj t'a mbajmë një minutë heshtje. I lehtë i qoftë dheu i Kosovës. Sot po ashtu shënohet edhe përvjetori i dëshmorëve të UÇK-së, Istref Emini dhe Alush Mustafa, të cilët e sakrifkuan jetën për lirinë dhe pavarsinë e vendit tonë dhe në shenjë nderimi, ju ftoj t'a mbajmë një minutë heshtje për veprën e tyre. Lavdi Dëshmorëve!

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi, Kuvendit i prezantoi këtë:

REND DITE

1. Dhënia e Betimit të anëtarit të ri të Kuvendit z.Asllan Beqaj,
2. Shqyrtimi i Ekstrakt - Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 02.04.2026,
3. Pyetje-Përgjigje,
4. Rishqyrtimi i Vendimit Npi- 01/35, datë 05.03.2026 për zgjedhjen e Komitetit për Komunitete sipas rekomandimit të MAPL-së,
5. Rishqyrtimi i Rregullores Npi-01/45, datë 05.03.2026 për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2026 sipas rekomandimit të MAPL-së,
6. Pasqyrat Financiare për vitin 2025,
7. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komunës për periudhën 3 mujore Janar-Mars 2026.

Vazhdojmë me rendin e ditës. Hapi diskutimin për rendin e ditës. Pasi që diskutime për rendin e ditës nuk ka do ta hedhi në votim rendin e ditës. Konstatohet kuorumin prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Dhënia e Betimit të anëtarit të ri të Kuvendit z.Asllan Beqaj.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Të nderuar, ftoj z.Asllan Beqaj që të jep betimin.

z.Asllan Beqaj: Unë, Asllan Beqaj, betohem se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Shtimes, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Urime z.Beqaj. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Pika 2

Shqyrtimi i Ekstrakt - Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 02.04.2026

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Demokrat Mujota: Përshëndetje. Për shkak të shumë kërkesave tona të vazhdueshme për procesverbalin, kohën e fundit ka filluar me u rregullu ky problem. Nëse kemi vërejtje mundemi me bë kërkesë zyrtare tek zyra adekuate, por në përgjithësi është rregulluar shumë kjo çështje.

z.Shefqet Krasniqi: Përshëndetje. Urime z.Beqaj për betimin e dhënë, uroj për një bashkëpunim të mirë si Kuvend. Sa i përket çështjes së procesverbalit ne 2-3 herë kemi dhënë rekomandimet dhe vërejtjet tona. Ka përmirime por mbetet të përmisohet edhe pak, sepse nganjëherë po bëhet e tepërt por po mungon substanca e asaj që po e themi. Kërkojmë që të ketë vëmendje më të theksuar në këtë pjesë.

z.Haqif Arifi: Përshëndetje. Në diskutimin e dytë faqe 3 mungon një lidhëse që ia humb kuptimin krejt fjalës, duhet të shtohet fjala "nuk". Ndër pyetjet që ia kam bërë drejtorit të Prokurimit ka qenë një përgjigje e tij që "shkaku i mos dislokimit të fushës kemi pas një petition mos me disloku fushën" d.m.th nuk gjendet dhe kisha kërku që edhe kjo të futet që të jetë më e evidente, sepse kështu ka qenë përgjigjia e tij.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Nëse nuk ka diskutime për procesverbalin nga mbledhja e kaluar, konstatohet kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje po e hedhë në votim këtë pikë.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Ekstrakt - Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më: 02.04.2026, me vërejtje dhe rekomandime.**

Pika 3

Pyetje-Përgjigje

z.Bajram Hajrizi: Kam këto pyetje për Kryetarin: Në një debat televiziv në TV Dukagjini, një person që ishte edhe avokat emrin e kishte Muhamet Muja, i cili kishte bërë një koment denigrues, fyes e nënçmues për qytetarët e Komunës së Shtimes. Kryetari i kishte dalë në mbrojtje për këtë çështje, ndërsa pas fyerjës së Tom Gashit dhe Shkelzen Gashit që para disa javë i ka fyer familjet e martirëve dhe dëshmorët e Reçakut, a është dorëzuar padi, deri ku ka mbërritur padia për këtë çështje dhe cili avokat është i angazhuar për këtë rast? Gjatë mandatit të kaluar dhe mandatin që ka filluar tani, Kryetari Aliu ka premtuar furnizim të ujit për qytetarët e Shtimes 100%. Deri tash ka mungesë të madhe të furnizimit të ujit, sidomos në fshatin Reçak ku 60% e fshatit nuk është e furnizuar me ujë. Rrjeti i ujësjellësit është i shtrirë por është mungesë e furnizimit me ujë. Reçaku ka zgjidhje për ujë, do të ja shihin hajrin edhe fshatrat përreth? Pyetje për DKA; Kur do t'i shpallni konkurset për Drejtorë të shkollave, sepse të gjitha shkollat janë me U.D? Në muajin Tetor ka filluar renovimi në gjimnazin "Naim Frashëri", si është e mundur që të vonohet renovimi i një shkolle kaq shume kohë? Pse punët nuk po përfundohen siç duhet dhe sa kohë ju duhen që stafi dhe nxënësit e shkollës të kthehen në objektin shkollor për të filluar procesin e mësimin dhe pse janë ndalur punimet? Në fshatin Petrovë është duke u bërë ndërtimi i aneksit të ri të shkollës, a mos janë ndalur punimet edhe në këtë shkollë? Edhe në këtë vit shkollor nxënësit vijnë mësimin me orar shumë të shkurtër në mungesë të

hapsirave, klasëve për mësim dhe kur pritet të funksionalizohet shkolla? Pse sallat e Edukatës Fizike në fshatrat Godanc, Petrovë, Zborc dhe Reçak ende nuk janë hapur aktivitetet për nxënësit dhe kur do të hapen? Pyetje për DPUKGJ: Në rrugën “Ahmet Kaqiku” në Reçak ku shumica e banorëve e njohin si rruga e “Çestës”, ka kërkesë për rregullimin e një ure të re, pasi që ura që është aty është e demoluar. Në çdo reshje të shiut uji hyp mbi urë dhe rrezikon shumë familje për përmbytje, rrezikon poashtu edhe fëmijët që shkojnë në shkollë dhe këmbësorët që kalojnë mbi atë urë. Në planin e buxhetit e keni cekur ndërtimin e disa urave në Komunën tonë, a mund të përfshihet ndërtimi i një ure në këtë rrugë, sepse është kërkesë urgjente që kjo urë të rrënohet dhe të ndërtohet një urë e re? Në rrugën “William Woker” që i lidh fshatrat Reçak-Petrovë-Mollopolc, asfalti që është shtuar vitin e kaluar është dëmtuar shumë. Kapakët e pusëve kanë hyrë nën asfalt duke shkaktuar pengesë për transport dhe rrezik për personat që kalojnë në atë rrugë, pasi që shpesh shoferët detyrohen të kalojnë në anën tjetër, për shkak të gropave që janë krijuar në këtë rrugë. Madje edhe te kyçja e kësaj rruge kryesore që lidhet me rrugën “Tahir Sinani” nuk është e rregulluar siç duhet. Aty janë dal armatura dhe gropa që po shkaktojnë probleme sidomos për fëmijët që shkojnë në shkollë. Një kërkesë që është drejtuar me datë 19.02.2026 nga një veteranë i UÇK-së, Beqë Beqiri. Kërkesa ka të bëjë me shtrimin e rrugës në Petrovë, në vendin ku janë dy dëshmorë dhe martiarë që kanë rënë në atë vend në vitin 1999. A është marrë parasysh, po besoj se kjo kërkesë nuk duhet të vonuar për rishqyrtim sepse ia ka dhënë qytetit të Shtimes, tre burra që ju kanë bashkangjitur radhëve të UÇK-së? Pyetje për DSHP: Cilat janë veprimet që i keni ndërmarrë për ruajtjen e hapësirave publike, konkretisht parqet që po ndërtohen e po shkatërrohen në kohë rekord? Ku është problemi, a është cilësia e dobët e punimeve? Një kamion që e keni fitu donacion vitin 2022 për nevojat e KRM “Pastërtia” që keni dhënë edhe çmim “Qytetar Nderi”, a mendoni që i bën nder qytetit duke ndërtuar në oborret e institucioneve publike? Pyetje për DBPZHR: Gjatë vitit të kaluar është publikuar shpallja për dhënien e serrave në bujqësi dhe prej atëherë nuk është publikuar lista e përfituesëve. Ku gjendet lista me emrat e përfituesëve dhe tërë procedurat e vlerësimit të tij. Pse ende nuk janë shpallur emrat e përfituesëve? Pyetje për DKRS: Për dy vitet e fundit, sa klube sportive janë shuar në Shtime?

z.Muhamet Ademaj: Kam këto pyetje, për DPUKGJ: Sa është numri i objekteve pa leje i ndërtuar në prona komunale? Pyetje për DSHP: 200m afër palestrës sportive e kemi një deponi të mbeturinave inerte, aty hudhën të gjitha llojet e mbeturinave. A e keni në plan largimin e kësaj deponie? Qytetarët e Lagjes “Ademaj” dhe të fshatit Mollopolc po kërkojnë vendosjen e një shiriti të bardhë në rrugët “Hyre Emini” dhe “Skender Salihaj”? Pyetje për DZHE: Kur pritet aktivizimi i Zonës Ekonomike në fshatin Gllavicë?

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Unë nuk kam pyetje për Ekzekutivin po për kolegun parafolës. A është në njohuri për investimin që është 1.000.000 milionë euro që po bëhen në këtë fshat, sepse po të ishte në njohuri nuk do t’a bënte këtë pyetje. Koleg i nderuar para se të bësh akuza për mos reagimin e Kryetarit Aliu dhe mos investimeve që po bëhen në Reçak, ku vetëm në Memorialin e Reçakut janë duke u investuar hiç më pak se 1.000.000 milionë euro.

z.Bajram Hajrizi: Unë jetoj në Reçak dhe i di emocionet e atij fshati. E di çka i mungon dhe çka është investu, çka u prit me u investu dhe çka nuk është investu. Unë nuk e akuzova askënd vetëm dua t’a di se ku është procedura.

z.Demokrat Mujota: Pyetje për DBF: Janë dy këste që janë paguar për PZHK-në, kujt i janë paguar edhe kur pritet të vijë në Kuvend që të votohet PZHK-ja? Krijimi i një fondi të veçantë që të mirret vetëm me pagesat e kontratës kolektive, përgjigjia e juaj gjatë komunikimit ka qenë që “Komuna nuk ka të drejtë me e bë një linjë buxhetore të veçantë” dhe e kam hulumtuar këtë rast dhe po ka të drejtë Komuna me e bë, e kanë bë shumë Komuna. Nëse krijohet kjo linjë, asnjë projekt nga përmbartuesi privat nuk do të bllokohet, andaj ju lutem bëni analizat mirë. E kam një koment për Besnikun, iu referove asambleistit të PDK-së që nuk e dinë sa investime janë bërë në Reçak. A mundeni të n’a tregoni se a janë investuar 1 euro në Kompleksin Memorial të Reçaku gjatë mandatit tuaj? Krejt çka ka bërë Qemaj Aliu për fshatin Reçak është ndërtimi i Drejtorit të Shëndetësisë që e ka sjell nga Fushë Kosova me Kryetarin e fshatit Reçak, e ky nuk është përfaqësim. Në njeri që ka qenë milic në kohën e shqipërisë, a është ky dinjtet? Në vend që të

kërkoj falje dhe duke u munduar t'i laj gabimet e të kaluarës, e ka bërë znj. Mimoza Salihu Drejtoreshë, vajzën e dëshmorit të parë që është në Komunën e Shtimes.

z. Besnik Seferi: z. Mujota, e përmende vajzën e dëshmorit që sot e kemi përballë. znj. Mimoza ka qenë dhe është një ekonomiste e zellshme dhe shumë e sukseshme. Për vite me radhë ka apliku dhe asnjëherë nga pushteti i juaj nuk është bërë zgjidhje, e sot ju e përmendeni me atë pretekstin që qaq e ndershme që është pas atij ka ardhë kjo. Në atë nivel të ulët e sjellni diskutimin. Duhet të kemi kujdes se po prekni në ndjenja, nuk jam me bërë politikë por me thënë një realitet që jemi këtu.

z. Demokrat Mujota: Në asnjë moment nuk e përmenda znj. Mimoza në atë kontekst që po pretendoni, por e përmenda se si qeverisja juaj mundoheni me e mbyllë një gabim të madhë me dy njerëz që kanë vlera atdhetare me z. Adem Ramdani si Kryetar i Reçakut dhe znj. Mimoza Salihun si vajza e dëshmorit të parë, z. Ruzhdi Salihut. Jam ballëhapur sepse jemi krenar sepse lufta është e popullit dhe idealet e PDK-së janë realizuar.

znj. Adelina Shabani: Përsëritet. Po më duket pak se çështja e vlerave të luftës është tepruar nga ana juaj, PDK është njëra nga partitë më të pakta që duhet të flet për vlera të luftës. Keni trashë veteranë mbi veteranë, ku janë vlerat e juaja, çfarë statute keni bërë se të gjithë jemi të prekur. Vlerat e luftës janë treguar ku janë treguar, këtu jemi me vendim të qytetarëve dhe jemi për qytetarët.

znj. Arbresha Sylja: Përsëritet. Këtu jemi për qytetarët, nuk ka nevojë të mbrohet Kryetari. Mendoj që pyetjet të drejtohen më shumë për punën, aktivitetin dhe për të mirën e qytetarëve, e jo për çështje politike se tek e fundit jemi vetëm një Kuvend i Shtimes.

z. Asllan Beqaj: Përsëritet. Është seanca e parë dhe po më kujtohet nga legjislatura e kaluar ka pasur kundërshtime për ish-Kryesuesin z. Adnan Ademi sa herë që ka pas devijime të seancës, tash po e shoh që po eskalon. Vlerat e luftës janë më të mëdha se Kuvendi i Shtimes, nëse diskutojmë ka me zgjatë pa masë kjo seancë dhe pa konkluzion.

z. Shefqet Krasniqi: Mimoza, do të donim edhe që prindërit tonë t'a kishin epitetin "Hero".

z. Haqif Arifi: Kam këto pyetje: Pyetje për të gjithë Drejtoritë: Cilat janë projektet kryesore gjatë këtij vitit? Kur pritet të fillojnë projektet në fshatrat që ende nuk kanë filluar? A mund të n'a premtoni se në çdo fshat do të fillohet nga një projekt këtë vit? Pyetje për DPUKJGJ: Sa projekte infrastrukturore janë në realizim aktualisht, kur priten të fillojnë investimet në fshatrat që janë lënë anash? Pyetje për DSHP: Si qëndron gjendja e furnizimit me ujë dhe menazhimin e mbeturinave nëpër fshatra? Pyetje për DBF: Si është shpërndarë buxheti mes fshatrave? Pyetje për DPP: Kur do të mundem t'i marrë përgjigjet e pyetjeve që i kam bërë në mbledhjen e kaluar?

z. Faruk Beqa: Përsëritet. Kërkoj që t'i përmbahemi pikave të rendit të ditës.

znj. Erza Salija: Përsëritet. Kam këto pyetje: Pyetje për DSHP: A është në planet e kësaj drejtorie një ndërhyrje e trotuarëve në rrugën "William Woker", pasi që nuk po bëhet rregullimi i tyre të paktën le të bëhet pastrim dhe mirëmbajtje? Rrugë tjetër që ka nevojë për ndërhyrje është rruga "Qorr Ilazi" në Reçak, e cila është vështirë e kalushme. Nëse nuk është në planet e kësaj drejtorie kjo rrugë, atëherë le t'a marrin si kërkesë nga ana ime.

z. Demokrat Mujota: Asambleistët e PDK-së nuk e futën çështjen e vlerave të luftës, asambleisti i LVV-së e hapi këtë temë, e dyta unë flas për vlera të luftës. Kam familjarë dëshmorë, anëtarë të zhdukur të familjes, ndryshe nuk kam më shumë të jap për këtë vend. E treta padashje. Ju kërkoj falje kushdo që është prek nga diskutimi si rasti i Mimozës, qëllimi ke me tregu një realitet.

z. Muhamet Ademaj: Kërkoj nga ju kolegë, që t'a respektoni rregulloren e Kuvendit.

z. Shefqet Krasniqi: Pyetja ime kërkon edhe një përmisim nga ana juaj, do të jetë edhe si lloj kërkesë. Pyetja jonë nuk kërkon përgjigje, por kërkon përgjegjësi. Është bërë një marrëveshje publiko-private mes Komunës së Shtimes dhe biznesit "Fitorja SH.P.K", për ndërtimin e një objektit banesor të Shtëpia e Kulturës dhe sipas informatave që kemi aty janë 9 banesa që tani i takojnë komunës dhe që ende nuk janë shpërndarë, kërkoj informata të sakta, kontratën dhe aneks kontratën e asaj marrëveshje. Sa banesa janë, cila është pasuria e komunës dhe se për cilët kategori në ato kohë janë emëruar ato banesa? Pse edhe pse kaq shumë vitesh nuk po

shpërndahen ato banesa? Kërkoj që të formohet një komision, që të gjenden “çelësat” e këtyre banesave dhe të ju shpërndahen qytetarëve.

znj.Albana Podvorica Hoxha: Përshëndetje. Kam këto pyetje: A do të mirren masa urgjente për rrugën “Mic Sokoli” nga rrëshqitja e dheut? Banorët e rrugës “Imer Devetaku” kanë bërë kërkesë për vendosjen e një pengese në rrugë, por ende nuk i është kthyer një përgjigje? Në rrugën “Tahir Sinani”, është urgjente vendosja e vendkalimeve për këmbësorë? Pyetje për DSHP: Kërkoj që të merren masa sa më shpejt për vendosjen e shportave të mbeturinave dhe të bëhet rregullimi i tyre.

znj.Fatlinda Rrafshi: Përshëndetje. Kam këto pyetje: Pyetje për DBF: Sa është duke u shpenzuar për pjesën e marketingut, për video inçizimet me drona kur e dimë që edhe Zyra e Informimit mundet me i kry këto punë dhe sa ka qenë e nevojshme që të bëhet edhe një kompani private për realizimin e këtyre fotografive?

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: Përshëndetje. Nga përvoja ime si Kryesues në mandatin e kaluar, nuk kam lejuar që në pikën Pyetje-përgjigje të zhvillohen diskutime. Si këshillë, ju kërkoj t’a respektoni rregulloren. Çështja e parë që u adresua ishte nga z. Hajrizi, lidhur me padinë ndaj Tom Gashit. Ju e dini që kemi pasur edhe takime për këtë çështje. Përveç deklaratës skandaloze që e ka dhënë Tom Gashi, ne kemi reaguuar me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Padija është dorëzuar nga avokati i Komunës. Nuk e dimë në çfarë faze ndodhet, pasi nuk punojmë në Gjykatë, por obligimi ynë ka qenë ta dorëzojmë padinë përmes përfaqësuesit institucional. Tashmë mbetet që Gjykata të vendosë për rastin. Sa i përket ujësjellësit, ju e dini që në fshatrat Rashincë dhe Gllavicë po punohet për rritjen e kapacitetit të ujit, pavarësisht pengesave që janë bërë gjatë fushatës nga opozita dhe disa aktivistë politikë. Projekti ka vazhduar dhe është drejtë përfundimit. Një projekt tjetër është në fshatin Pjetërshicë, ku sipas ekspertëve që kanë hartuar projektin, rreth 80% e rrjetit të ujësjellësit tashmë është shtrirë. Në fshatin Reçak është investuar, Kryetari Aliu ka pasur zotim që Kompleksi Memorial të jetë një nga projektet më të mëdha, jo vetëm në Komunën e Shtimes, por edhe në nivel nacional, pas Jasharajve të Prekazit. Sa i përket çështjeve tjera, ju e dini për rrugën që ka kushtuar rreth 400 mijë euro, si dhe për disa rrugë të tjera. Buxhetin e keni përpara, prandaj lexojeni, sepse edhe vetë e keni votuar. Probleme me përmbarues ka në të gjitha komunat. U përmend edhe çështja e një kodi të veçantë buxhetor për pagesën e kontratës kolektive. Por ku keni qenë ju që nga viti 2016, kur ka hyrë në fuqi kontrata kolektive dhe nuk është bërë asnjë pagesë? Është dashur të vijë LVV-ja në vitin 2022 për të filluar pagesat, të cilat po ndikojnë rëndë në realizimin e projekteve. Kuvendi nuk duhet të keqpërdoret për çështje të luftës. Lufta përkujtohet me vepra. Reçaku duhet të ngritet si projekt nacional, ashtu siç po bën Kryetari Aliu. Lufta nderohet duke investuar në rrugë dhe infrastrukturë pranë çdo shtatoreje të dëshmorëve dhe në zonat ku ka luftuar UÇK-ja. Lufta përkujtohet me vepra, jo vetëm me fjalë. Gjithashtu, duhet ta dini se çështja e përmbaruesve ka prek edhe komunat e tjera. Komuna jonë po e menaxhon këtë situatë sa më mirë. Përmbaruesi lidhet edhe me kontrata të pronave nga viti 2016-2017, ku sot komunës i vijnë pagesat përmes përmbaruesit. Përmbaruesi e njeh komunën si institucion, jo partitë politike si LVV, PDK apo LDK. Ne, bashkërisht, duhet të mundohemi të dalim nga kjo situatë dhe jo të krijojmë bllokada. Kur them bllokada, e kam fjalën për aspektin brenda Kuvendit, sepse ju nuk mund ta bllokoni punën, pasi qytetarët nuk jua kanë dhënë atë mundësi.

znj.Mimoza Salihu: Përshëndetje. Se a ka bërë punë Kryetari Aliu për vlerat e luftës këtë e dëshmoj më së miri unë, pasi që pas 24 vitesh dëshmori i parë në Komunën e Shtimes prindi im, është shpallur hero. Personalisht, prej moshës madhore kam trokitur në dyert e “institucioneve” për shpalljen hero të prindit tim, por gjithmonë kam marrë përgjigje negative. Të nderuar asambleistë, për mua është nder nga kryetari Aliu emërimi im si drejtoreshë e Shëndetësisë. Përveç si vajzë dëshmori, ky emërim është bërë edhe mbi bazën e profesionalizmit tim, gjë që ka munguar më herët. I nderuar asambleist Mujota, le të jetë hera e fundit që emri im dhe i prindit tim përmenden në këtë mënyrë.

z.Shefqet Krasniqi: Kam dy kërkesa për ju Kryesues: ta menaxhoni kuvendin dhe 5 minuta pauzë.

z.Demokrat Mujota: Çështja e vlerave të luftës u nis nga grupi juaj. Në asnjë variant nuk thash që lufta e UÇK-së i takon PDK-së. Ju duhet të ndiheni krenare për prindin tuaj, po duhet t'i themi disa gjëra të vërteta. Realiteti është i pamohueshëm që juve Qemajl Aliu iu ka përdorur.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Në rregull po shkojmë në pauzë 5 minuta në ora 11:35h. Vazhdojmë mbledhjen në ora 11:47h. Konstatoj kuorumin prej 13 anëtarëve prezent në mbledhje dhe fjalën ia jap znj.Albana Podvorica Hoxha.

znj.Albana Podvorica Hoxha: Banorët e rrugës “Imer Devetaku” kanë bërë kërkesë për vendosjen e një pengese në rrugë, kërkoj një përgjigje konkrete për këtë problem?

z.Faik Ramdani: Përhëndetje. Nuk jemi mbledhur me ndryshu Kushtetutën, por për kërkesat e qytetarëve. Kam këto pyetje dhe kërkesa: Objekti i shkollës “Idriz Ajeti” është në gjendje jo të mirë ku rrezikohet edhe jeta e nxënseve, kërkoj që të verifikohet. Kërkoj edhe një miratim për pëlqim për një ankesë kolektive ku rryma në fshatin tonë është jashtëzakonisht e tmerrëshme, dhe kërkoj miratimin që t'ia bashkangjesë ankesës time. Kemi nevojë për rivitalizimin në rrugët “Izet Ajeti”, “Idriz Ajeti” dhe “Rrezja” në Pjetërshticë. Pse u ndalua rivitalizimi i rrugës “Rrezja”, kërkoj sqarim nga ekzekutivi? Ura që është duke u ndërtuar në Pjetërshticë, është një urë me standarte por përfshimja e asaj ure është shumë e vogël në krahasim me kërkesat që kemi. Ura kryesore e fshatit Pjetërshticë ka nevojë për një mbrojtëse, sepse kemi pasur edhe shumë aksidente. Në rrugën “Mehmet Arifi” kemi nevojë për një trotuarë. Rruga “Dushkaja” ka nevojë për ndriçim dhe trotuarë, rruga “Tafil Musolli” një pjesë shumë e vogël ka nevojë për ndriçim. Rruga “Isak Brahimi” ka nevojë me shiku me zgjeru. Fusha e futbollit ka nevojë për ndërhyrje dhe mundësi zgjerimi të saj. Kemi nevojë për rregullimin e parkut “Ushtria Çlirimtare” poashtu në Pjetërshticë. Kam një kërkesë edhe nga lagjia “Rrusta” në rrugën “Anton Çeta”, ata kanë nevojë për shpronësim të një pjese ku duhet të kalojë kanalizimi që përfshin 9 shtëpi. Kërkesë nga ferma që është në Pjetërshticë dhe Restaurant “Kroni” që nuk janë të përfshira në sistemin e ujësjellësit që është duke punuar “KRU Prishtina” në Pjetërshticë. Bizneset tona po ndihen të diskrimnuar prej komunave të tjera sepse në vend që të punojnë bizneset, ata po kërkojnë me çdo kusht shfuqizimin e këtij vendimi. Dua të marrë një iniciativë bashkarisht me filluar një aksion për pastrimin e qytetit të Shtimes, ajo është një nevojë. Jam i bindur që mund t'a bëjmë dhe kërkoj përkrahjen tuaj.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Sa i përket kërkeses së KEDS-it mund të ma përcjellni edhe në email dhe mundemi me nxerr një konkluzion. Kërkesa tjetër për pastrimin e qytetit mendoj që është ide e qëlluar.

z.Shefqet Krasniqi: Në emër të LDK-së e keni përkrahjen tonë. Deshta të ngris një çështje për fshatin Carralevë, është një rrugë e papërshtatëshme tek pjesa e varrezave dhe kërkon ndërhyrje sa më të shpejtë. Tek çështja e banesave është në interesin e të gjithëve që të gjenden “çelësat”. Kërkoj që të formojnë komision, nga 3 anëtarë nga secila parti politike dhe të fillon punën ky komision.

z.Muhamet Ademaj: Qytetarët e Lagjes “Ademaj” dhe të fshatit Mollopolc po kërkojnë vendosjen e një shiriti të bardhë në rrugët “Hyrë Emini” dhe “Skender Salihaj”, kurse z.Ramdani e keni përkrahjen time për këtë iniciativë.

z.Faruk Beqa: Është ide e mirë dhe e konsideroj që të gjithë duhet ta mbështesim kur bëhet fjalë për pastrimin e vendbanimeve tona në Komunën e Shtimes. Mirëpo, konsideroj se duhet të merremi edhe me shkakun e problemit. Edhe sa isha nënkryetar, bashkë me ekzekutivin jemi munduar të gjejmë një deponi për hedhjen e mbeturinave inerte, sepse kur ne nuk e kemi bërë zgjidhjen, nuk mund t'i akuzojmë qytetarët se ku mund t'i hedhin ato. Nëse dikush e prish një shtëpi, materialet e forta nuk ka ku t'i hedhë. Unë po e them nga kjo foltore se DSHP-ja dhe ekzekutivi duhet të merren seriozisht me këtë çështje. Është edhe obligim ligjor që të gjendet një deponi. Ne i kemi identifikuar tri vende se ku mund të jetë deponia për mbeturina inerte, por çështja ka mbetur te menaxhimi i saj. Mirëpo, duke qenë se jemi në fazën e hartimit, bashkë me GIZ-in gjerman, të planit për menaxhimin e integruar të mbeturinave, ju e dini se shtetet tjera i klasifikojnë mbeturinat nëpër shporta të veçanta. Ne ende nuk kemi arritur në këtë fazë, por besoj se do të arrijmë ta bëjmë ndarjen e mbeturinave si xhami apo plastika.

z.Demokrat Mujota: E përgëzoj Faikun për iniciativën, por problemi kryesor nuk është të mbetjet inerte por të mbeturinat, të mos gjobitja e atyre personave që hudin mbeturinat, mos vetëdijësimi i qytetarëve dhe të bëhet rritja e numrit të inspektorave. Kërkoj përgjigjen e pyetjes që e bëra për PZHK-në.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Kërkoj nga ekzekutivi të marrë fjalën që t'iu jepen përgjigjet për pyetjet e bëra. Fjalën ia jap z.Besnik Ahmetit, DBF.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Përsëndetje. U bë pyetje për me u kriju një linjë. Duke u bazuar në praktikën e disa komunave, por para se të bëhet kjo pyetje është mirë të lexohet Qarkorja Buxhetor dhe Ligjin për Buxhet dhe Financa. Unë dua të marrë shembull komunat që bazohen në ligj, jo ato që nuk bazohen. Pagesat për vendime gjyqësore janë kryesisht pagesa të kontratës kolektive. Qarkorja Buxhetore 1 dhe 2 përcakton se sa buxhet të lejon me destinu të kategoritë e pagave, nuk mundesh me lënë buxhet të kjo kategori sepse Qarkorja t'a kthen, por nëse lëmë buxhet të kategoritë tjera ne e shkelim ligjin. Të gjitha komunave është duke u dalur raporti i kualifikuar dhe të gjitha janë duke e humbur Grantin e Performancës. Pyetje tjetër është se si është shpërndarë buxheti nëpër fshatra. Buxheti është shpërndarë duke u bazuar në numrin e banorëve, territorin dhe kërkesat që kanë rrjedhë nga dëgjimet publike. Sa i përket PZHK-së është paguar 43.500 mijë në vitin 2024, kurse me përgjegjësi të plotë them që nuk është paguar as në vitin 2025 as në 2026. Sa i përket shpenzimeve për marketing këtë përgjigje ua jap me shkrim, sepse kërkuat edhe për vitet e mëherëshme. Për këtë vit nuk ka pagesa ende për marketing.

z. Grejtalb Emini, DZHE: Përsëndetje. Ne e kemi filluar procedurën e prokurimit për hartim të PZHK-së dhe HZHK-së në vitin 2024, pagesa është bërë vetëm për PZHK-në. E kemi Draftin e PZHK-së i cili është dorëzuar në Ministrinë e Ambientit, mirëpo është dorëzuar në kohën e zgjedhjeve dhe n'a u kan kthyer disa plotësim-ndryshime. Jemi në fazën e përgjigjeve dhe pastaj merrret pëlqimi nga Ministria, e hapim dëgjimin publik dhe nëse nuk ka ndryshime vjen si Draft dokument në Kuvend Komunal në vjeshtën e këtij viti.

z.Haqif Arifi: Fillimisht dua ta përgëzoj Nënkryetarin dhe dy Drejtorët për përgjigjet që na i dhanë. Një pyetje për Nënkryetarin: a është më mirë që këta Drejtorë të qëndrojnë këtu për të na dëgjuar neve dhe qytetarët, apo është më mirë të lirohet salla? Nuk mund ta lëmë në heshtje propozimin e z.Faik, sepse unë mendoj se është një propozim vital. Pavarësisht institucionit që e ka obligim, kjo është një iniciativë shumë e mirë dhe së paku në mbledhjen e ardhshme duhet të formohet një komision. Është mirë që të jenë të gjithë Drejtorët këtu, sepse ju nuk mund ta merrni të gjithë barrën mbi vete. Unë parashtrova pyetje edhe për urbanizmin, edhe për shërbimet publike, por nuk mora përgjigje.

z.Faik Ramdani: Kam edhe një kërkesë nga bizneset e Shtimes. Bizneset tona po ndihen shumë të diskriminuara nga ndalesa që është marrë më herët për të mos punuar ditën e dielë. Kam biseduar me shumë biznese dhe ata po ndihen të diskriminuar në raport me komunat tjera, sepse derisa bizneset tona e kanë të ndaluar punën, qytetarët po shkojnë në komuna tjera për të bërë blerje. Bizneset tona kanë kredi, obligime dhe shumë barrë të tjera financiare, prandaj kjo situatë po i dëmton seriozisht. Për këtë arsye, bizneset po kërkojnë me çdo kusht që të shfuqizohet ai vendim për ndalimin e punës ditën e dielë. Besoj se duhet të gjejmë një zgjidhje për bizneset tona, sepse me të vërtetë po ndihen të diskriminuara.

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: Te banesat të Fitorja, zyrtarët tanë janë duke punuar në këtë drejtim. Dyert janë të blinduara që duhet të hapen, më pas mund ta themelojmë komisionin. Ne e kemi filluar dhe mund të vazhdojmë së bashku. Sa i përket furrave në fshatrat Dugë dhe Karaqicë, DSHP i ka mbyllur bashkë me policinë. Furrat nuk do të ndizen. Edhe nëse ndizen përsëri, ato do të asgjësohen. Për rrugën "Imer Devetaku", do të flas me drejtorin. Nuk mund të jap përgjigje të saktë sepse nuk e di nëse, për shkak të kontratave mund të vazhdohet me këtë çështje. Nëse kontrata është aktive, do ta bëjmë menjëherë. Nga fshati Pjetershticë e dimë që janë duke u kryer punimet për rrymën, ujësjellësin, urat dhe të gjitha do të përfundojnë. Për drejtorët që nuk janë prezent, por që kanë edhe angazhime tjera, ndërkohë do të na bashkohen. Sa i përket ndalesës që është bërë me rregullore, kjo iniciativë është ndërmarrë që e diela të jetë ditë pushimi. Është bërë një peticion nga bizneset, me arsyetimin se edhe punëtorët kanë nevojë për

pushim, jo vetëm bizneset të mendojnë për përfitim. Në kohën e sezonës bizneset lirohen të gjitha. Mendoj që kjo rregullore duhet të mbetet kështu. Të dielën ka kujdestari dhe secili biznes e ka ditën e vet, por nëse ka peticion prej bizneseve, nuk mundemi me e ndalu.

z.Grejtalb Emini, DZHE: Duke marrë parasysh se zona ekonomike ndodhet jashtë PZHK-së, komuna nuk ka mundur të pajiset me pëlqimin nga Ministria e Bujqësisë dhe Pylltarisë. Në momentin kur PZHK-ja miratohet në Kuvend, Ministria e Bujqësisë do ta japë pëlqimin për zonën ekonomike, dhe më pas do të aplikojmë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për shpalljen e saj si zonë ekonomike.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Faleminderit të gjithëve për diskutimet. Pyetjet-përgjigjet që kanë mbetur, ju lutem i drejtoni me shkrim.

z.Faik Ramdani: Bizneset po kërkojnë mos me qenë të diskriminuar, sepse në komunat tjera përreth punohet. Nëse bëhet nga niveli qendror bëhet për të gjithë pastaj.

z.Shefqet Krasniqi: Te çështja e bizneseve ka mungesë të hyrave të parave te bizneset dhe shpenzimeve të qytetarëve tanë që duhet të shkojnë në Ferizaj, Koshare ose Lipjan për t'u pajisur me gjëra ushqimore. Shtimja është e vogël dhe kanë kërkesë dhe interesim që kjo rregullore të shfuqizohet.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Është mirë që bizneset të bëjnë ndonjë kërkesë për shfuqizim, pasi ligji e lë në vetëmenaxhim të komunës vendimmarrjen për këtë çështje. Mund të inkurajohen bizneset që të paraqesin një kërkesë të tillë, fjalën ia jap Nënkrjetarit z.Adnan Ademi.

Nënkrjetar, z.Adnan Ademi: Në tri rrugët kryesore në komunën tonë janë marketet e hapura. Kjo nuk është çështje e qytetarëve, por e disa bizneseve. Ka qenë rregullorja në fuqi dhe ka ardhur një biznes e ka hequr këtë rregullore, por nuk duhet ta heqë biznesi, duhet ta heqim ne si kuvend. Bizneset kanë problem me fuqinë punëtore. Nuk humb një biznes nëse të dielën e ka pushim.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Konsideroj të mbyllur pikën Pyetje-përgjigjie. Vazhdojmë në pauzë dhe kthehemi në 13:45h.

Pika 4

Rishqyrtimi i Vendimit Npi- 01/35, datë 05.03.2026 për zgjedhjen e Komitetit për Komunitete sipas rekomandimit të MAPL-së

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Vazhdojmë pas pauzës në ora 14:05. I vetmi dokument që e rregullon çështjen e KPK-së është një udhëzues i Qeverisë, ku thuhet se Kryesuesi duhet të mbajë një takim publik me anëtarët e komuniteteve. Në ora 18:30 dje kam mbajtur një takim ku janë pranuar propozimet nga komunitetet. Janë propozuar këta kandidatë: Rrahman Kadrija, Gyltene Osmani-Ilazi nga Komuniteti Rom, si dhe Arton Demiri, i cili ka shprehur dëshirën të jetë anëtar i komunitetit. Ka pasur edhe propozime të tjera; disa prej tyre i njohim, ndërsa disa jo. Si Kryesues i Kuvendit, jam munduar të veproj në përputhje me udhëzuesin e Qeverisë së Kosovës. Tani do t'i paraqes këto propozime para jush, ndërsa në fund, besoj se me votën tuaj do të vendoset lidhur me këtë komunitet. E hap debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Haqif Arifi: Jam falenderues për punën që keni bërë. Megjithatë, kam interesim të di më shumë rreth mënyrës se si kanë qenë të përfshirë përfaqësuesit e komuniteteve. Unë jam në dijeni se ka pasur persona të interesuar apo të propozuar që kanë paraqitur kërkesa, ndër ta edhe Bajram Ilazi. Megjithatë, do të doja të di nëse ai ka qenë i njohuar për takimin që është mbajtur, apo nëse ka marrë pjesë në proces. Gjithashtu, a është tërhequr vetë nga kandidatura, apo nuk ka qenë i përfshirë në takim dhe për këtë arsye është larguar nga lista e propozuar?

z.Asllan Beqaj: Fillimisht kërkoj nga ju që të kem mundësi të kem procesverbalin e asaj mbledhje dhe listën e nënshkrimeve të anëtarëve që kanë qenë pjesëmarrës. Gjatë mandatit të kaluar asnjëherë nuk na ka ndodhur të mbajmë ndonjë votim të fshehtë për asnjë komunitet, të gjitha kanë qenë transparente dhe secili ka mundur të votojë. Ju e dini që çdo kthim i jashtëligjshëm nga MAPL-ja shkon minus pikë për Komunën e Shtimes. Te rregullorja e Kuvendit për kërkesa, këtu e kam parë një ndërhyrje, sepse rregullorja thotë se vetëm një pikë

mund të shtohet në rend dite, ndërsa janë shtuar 2-3 pika në rendin e ditës. Gjatë këtij vendimi duhet të kemi parasysh që të mos shkelet ligji.

z.Shefqet Krasniqi: Sa i përket çështjes së komuniteteve, u tha vetëm ajo që desha të them: a kanë qenë të njoftuar dhe çka ka ndodhur lidhur me Bajramin. Sa i përket mendimit të z. Beqaj, Kuvendi mund të nxjerrë rregullore, por ato rregullore duhet të jenë në përputhje me ligjin. Deri më tani nuk kemi shkelur asnjë procedurë ligjore.

z.Muhamet Ademaj: Duhet të ketë barazi mes komuniteteve.

z.Haqif Arifi: Sa i përket rendit të ditës rregullorja neni 6.7 shumë qartë shkruan: "Anëtari i Kuvendit ka të drejtë të propozojë një pikë të rendit të ditës" nuk thotë kuvendi. Rekomandimi është opinion ligjor dhe konsideroj që nuk ka kurrëfar shkelje të ligjit.

z.Demokrat Mujota: Në mbledhjen e kaluar, kur është votuar për Komitetin për Komunitete, në kushte normale është dashur të vijnë 4 propozime. Mirëpo, për shkakë të rrethanave dhe propozimeve të ardhura nga kolegët tanë, kanë ardhur gjithsej 9 emra nga komunitetet. Ne nuk kemi dashur ta largojmë apo përjashtojmë askënd, prandaj kemi kaluar në votim të fshehtë, në mënyrë demokratike, që secili ta ketë të drejtën e votës për një person. Në bazë të votave të marra është nxjerrë rezultati adekuat dhe janë votuar emrat që kanë kaluar sipas procedurës. Nuk ka qenë dëshira jonë që të dëmtohet apo të anashkalohej ndonjë komunitet, por situata ka qenë e tillë që jemi gjendur para një akti të kryer. Kjo është kronologjia e ngjarjes që ka ndodhur. Sa i përket MAPL-së, ajo nuk e obligon Kuvendin për ndonjë shkelje ligjore, mirëpo ne duhet ta respektojmë rekomandimin e tyre për shkakë të Grantit të Performancës, në mënyrë që komuna të mos pësojë ndëshkime.

z.Adnan Ademi: Nga përvoja, raste të tilla nuk kanë shkuar në votim të fshehtë. Arsyeja politike pse është bërë votimi i fshehtë ka qenë sepse dikush u ka premtuar dy personave se do të jenë pjesë e Komitetit për Komunitete, dhe për ta mbuluar këtë situatë është propozuar votimi i fshehtë. Kemi shkuar në dy raunde votimi. Në raundin e dytë ju kam paralajmëruar që të mos votohet në atë formë, sepse Arton Demiri mund ta rrëzojë këtë vendim me një ankesë. Ministria nuk është aty vetëm për të dhënë rekomandime; ajo e kthen vendimin për rishqyrtim. Nëse i njëjti veprim përsëritet, atëherë bëhet shkelje dhe gjykata mund ta rrëzojë vendimin. Kur gjykata e rrëzon një vendim, dikush duhet të mbajë përgjegjësi për atë proces. Edhe rregullorja, kur ndryshohet, duhet të ndiqen procedurat dhe rregullat përkatëse, sepse përndryshe edhe ajo kthehet në pikën zero. Sot e keni më të lehtë, vetëm votoni Arton Demirin për përfaqësues të komunitetit rom dhe nuk ka nevojë të luhet as gjyqësori e as avokati i kuvendit, përndryshe çështja do të kthehet përsëri në rishqyrtim.

z.Shefqet Krasniqi: Si të veprohet kur ka më shumë kandidatë për të votuar se sa që duhet me shku sepse 90% kemi deklaruar që asnjërin nga ta nuk po e njohim. Mirëpo ne ram në dilemë sepse kishte më shumë kandidatë dhe për ata u kërkua që të votohet.

z.Adnan Ademi: Keni votuar me votim të fshehtë dhe nga kandidatët që kanë mbetur në raundin e dytë, është dashur automatikisht të respektohet përfaqësimi i komuniteteve. Kandidati nga komuniteti ashkali, i cili ka qenë më i votuari, nuk ka mundur të largohet apo të rrëzohet, sepse i ka marrë votat në mënyrë legjitime. Ndërsa nga dy kandidatët që kanë mbetur mes vete në raundin e dytë, është dashur të zgjidhet një kandidat nga komuniteti rom, në mënyrë që të ruhet balanca dhe përfaqësimi i drejtë i komuniteteve në Komitet.

z.Rrahman Jakupi: Kërkoj nga ekzekutivi që të mos përzihet në punën e Kuvendit. Sa i përket pretendimeve për shkelje ligjore, MAPL-ja sjell opinione ligjore dhe jo vendime detyruese. Komunitetit ashkali i takon shumica prezente në Komitetin për Komunitete. Unë kam thirrur takim publik ashtu siç e kërkon udhëzuesi i Qeverisë së Kosovës. Pjesëmarrësit kanë qenë prezent dhe kanë deklaruar se janë njoftuar me kohë, përfshirë edhe Arton Demirin, të cilin e kam njoftuar personalisht. Ekziston edhe procesverbali i takimit që e dëshmon këtë. Komuniteti shumicë ka vendosur atë ditë që në mes të Gyltene Osmanit Ilazi dhe Bajram Ilazit, të përzgjidhet Gyltene Ilazi. Kjo për shkak se janë edhe nga e njëjta familje. Nuk ka qenë propozim i imi personal, por vendim i marrë nga komuniteti. Kjo ka qenë rrjedha e gjithë procesit.

z.Besnik Seferi: Nuk është marre me pranë që e keni bërë shkeljen ligjore ju bashkë me LDK-në. Shkeljen e keni bërë nga fillimi kur është startu, e keni lënë Arton Demirin jashtë e që po

mundoheni me u nxjerr nga gabimet e juaja që i keni bërë. Nuk e di çka po e stërzgatni. Lus LDK-në mos të kërkoj procese aq “demokratike” sa mos të ketë të jep guxim të jep një votë me dorë të ngritur.

z.Muhamet Ademaj: Unë mendoj që është më e lehtë me e nda drejtësin nga ana e anëtarëve të Kuvendit, ne i kemi dy komunitete që jetojnë në Komunën e Shtimes janë Komuniteti Ashkali ti zgjedhmi 3 anëtarë nga ky Komunitet ,edhe 1 nga Komuniteti Rom kështu që gjithçka është në rregull Kryesues se deri më tani i kemi njoftur vetëm dy Komunitete në Komunën e Shtimes.

z,Rrahman Jakupi: Në Shtime unë bazohna në dokumentacion zyrtar këtu e kam besoj që do ta keni edhe ju një dokument kopje. Në komunën e Shtimes po del qe kemi edhe komunitet Boshnjak, Egjiptas edhe Turk kështu janë deklaruar është dokumentë zyrtar Rom edhe Ashkali ju i përmendët këto dyja. Çështja tjetër është diskutimi i shkeljeve ligjore, askush nuk mundët me e ditë se si kam votuar unë se cilin e kam votuar unë, nese thua se ti ke bë shkelje ligjore du me ju thënë se shkeljet ligjore i bënë Kuvendi, ky është vendim kolektiv nuk është vendim individual unë e udhëheqi seancën e jo procedurat. Nëse nuk ka tjera diskutime po i hedhë në votim emrat e propozuara.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes me 11 “Për” dhe 0 “Kundër” 7 “Abstenim” miratoi Vendimin për rizgjedhjen e Komitetit për Komunitete në këtë përbërje:**

1. Artan Lubovci - LVV,
2. Fatlinda Rrafshi – PDK,
3. Haqif Arifi – LDK,
4. Gyltene Osmani-Ilazi - nga komuniteti Ashkali,
5. Sabrie Veliu – nga Komuniteti Ashkali,
6. Rrahman Kadrija - nga Komuniteti Ashkali,
7. Arton Demiri – nga Komuniteti Rom.

Pika 5

Rishqyrtimi i Rregullores Npi-01/45, datë 05.03.2026 për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2026 sipas rekomandimit të MAPL-së

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: E kemi rregulloren komunale e cila është hartuar nga Administrata Komunale dhe në të njëjtën kohë është kthyer nga MAPL-ja si e kundërligjshme. Në këtë rregullore tek pjesa e Shëndetësisë janë disa nene të cilat MAPL-ja ka konstatuar se janë të kundërligjshme dhe patjetër që duhet të përmissohen.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Rregullorja për taksa, tarifa dhe gjoha ka qenë e njëjtë. Ministria ka rekomanduar të bëhen disa ndryshime, mirëpo unë mendoj se në një pjesë kanë gabuar. Ata kanë kërkuar të hiqet paragrafi 10.2.1, i cili është i përcaktuar në U.A., me arsyetimin se nuk i takon Kujdesit Parësor Shëndetësor. Kam biseduar me Zyrën Ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe i kam njoftuar se nëse e heqim atë paragraf, vendimi do të na kthehet përsëri, pasi ai ekziston në Udhëzimin Administrativ. Ndërsa për dy rekomandimet tjera, i kemi përmbushur sipas kërkesave të tyre. Gjithashtu, edhe pika 10.1.2 është e përcaktuar në U.A.. Rregullorja është përgatitur me të gjitha ndryshimet në përputhje me U.A. MAPL-ja ia ka kthyer MSH-së, ndërsa MSH-ja neve. Kjo pikë ekziston në U.A. dhe nëse e heqim, MAPL-ja do ta kthejë përsëri. Gjithashtu, ajo ka bërë gabim edhe te pika për të cilën kemi marrë rekomandim që të fshihet, konkretisht pika 10.2.27 “Vizita e parë stomatologjike”. Kjo pikë nuk mund të hiqet, sepse ekziston në U.A. të vitit 2024.

znj.Arbresha Sylja: Nëse ekziston ajo pjesa për mendim për mjekim jashtë vendit, atëherë po flasim për atë çështje. Konsideroj se është gabim nëse ajo është e përfshirë në U.A., sepse niveli parësor nuk jep mendim për mjekim jashtë vendit. Mendimin e jep Këshilli Konsiliar i përbërë nga tre mjekë dhe QKUK-ja. Ne po flasim për praktikën dhe mënyrën se si është vepruar deri më tani. Nuk po e kuptoj se si është përfshirë në rregullore që mjekësia primare të japë mendim për mjekim jashtë vendit. Te pjesa e dhëmbit, dhëmbi është llogaritur si pjesë estetike, nëse MAPL-ja e ka kthyer në këtë formë është jo shumë profesionale.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Nëse nuk ka diskutime tjera. Kuvendi e ka rishqyrtuar këtë dokument dhe po e hudh në votim që të përmisohet aty ku ka mundësi dhe të mbetet në harmonizim me U.A. Do të thotë po e votojm sipas rekomandimit të MAPL-së.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht, miratoi ndryshimet në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2026, me numër Npi-01/45 të datës 05.03.2026, sipas kërkesës së MAPL-së Nr.43-211/3 të datës 01.04.2026 për rishqyrtimin e kësaj Rregullore, si vijon:**

I-a Është larguar nga Rregullorja e Kuvendit me numër Npi-01/45 dt. 05.03.2026 Neni 5 në të cilin është thënë:

“Tarifat për shërbimet Online”

- 5.1 Për një përdorues GUI për person tarifa është.....20 €
- 5.2 Për një përdorues UCËSS si institucion100 €
- 5.3 Mirëmbajtja vjetore për shërbimet e ofruara online është.....200 €
- 5.4 Përfundimisht nga paragrafi 16.3 i këtij neni, bëhet për personat fizik dhe juridik të cilët regjistrojnë të drejtën e hipotekës;
- 5.5 Bazuar në paragrafin 16.4 të këtij, regjistrimi i hipotekës është 5 euro, ndërsa modifikimi dhe fshirja e saj është pa pagesë.
- 5.6 Verifikimi i informacioneve për njësi kadastrale është2 €
- 5.7 Verifikimi i informacioneve për person është6 €
- 5.8 Tarifat e përcaktuara në paragrafin 16.6 dhe 16.7 të këtij neni, vlejné për të gjitha institucionet publike dhe ato private që me ligj kanë autorizime publike.
- 5.9 Nxjerrja e certifikatave online është3 €
- 5.10 Lirohet nga tarifa për regjistrimin e shënimit nga përdoruesit sipas paragrafit 1 të këtij neni. Përdoruesi nga paragrafi 1 i këtij neni janë të obliguar që të bëjë rexhistrimin e shënimit.”

I.b Është larguar nga Rregullorja e Kuvendit me numër Npi-01/45 dt. 05.03.2026 Neni 6.2.3 në të cilin është thënë:

“6.2.3 Paragrafi 6, Nenparagrafet 6.2.1 dhe 6.2.2 lirohen nga të gjitha taksat komunale Institucionet Publike dhe donatorët.”

I.c Shtohet neni i ri i veçantë sipas radhitjes pas nenit 10.3.1.7 të Rregullores me numër Npi-01/45 dt. 05.03.2026, ku vjen te ndryshimi i radhitjes së neneve në Rregulloren Npi-01/76, për arsye të largimit të nenit 5 kështu që vazhdohet sipas radhitjes me nenin 9.3 si vijon:

“9.3 Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2024 për bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore konkretisht neni 5 dhe 8, dhe Ligji për Shëndetësi Nr. 04/L-125. Kategoritë e qytetarëve dhe banorëve të liruara nga bashkë pagesat sipas Ligjit për shëndetësi, janë:

- 9.3.1 Kategoritë e qytetarëve dhe banorëve të liruara nga bashkë pagesat sipas Ligjit për Shëndetësi, janë: 9.3.1.1 Personat që kanë të ardhura më të ulëta se niveli zyrtar i ndjeshmërisë sociale i përcaktuar nga Qeveria, në kategoritë e individëve të regjistruar si të ndjeshëm në aspektin social ose si të varfër, në bazë të aktit nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria përkatëse për Mirëqenie Sociale.
- 9.3.1.2 Viktima të trafikimit gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar, në pajtim me ligjin;
- 9.3.1.3 Banorët e përhershëm të vendbanimeve joformale në Republikën e Kosovës që nuk janë të regjistruar ose të cilët janë në proces të regjistrimit deri në përfundim të procesit të regjistrimit, ose deri një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, çfarëdo realizohet më parë;
- 9.3.1.4 Personat e ri-atdhesuar bazuar në marrëveshjet bilaterale të Republikës së Kosovës me shtetet e tjera, në vitin e parë pas ri-atdhesimit;
- 9.3.1.5 Të burgosurit të cilët janë në mbajtje të dënimit;
- 9.3.1.6 Personat të ç`vendosur me dhunë jashtë shtëpive të tyre si viktima të dhunës familjare, gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar, në pajtim me ligjin.
- 9.3.1.7 Dhuruesit e gjakut që posedojnë dëshminë e lëshuar nga QKKTGJ (Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut) se kanë dhënë gjak së paku pesë (5) 4 herë në dy (2) vitet e fundit. Dhuruesit me numër më të vogël të dhurimit të gjakut lirohen për 12 muaj të ardhshëm nga data e dhurimit të fundit.”

- I.ç** Është larguar nga Rregullorja e Kuvendit me numër Npi-01/45 dt. 05.03.2026 neni 10.1.2 në të cilin është thënë: “10.1.2 Formulari për trajtim jashtë vendit.....(lirohen)”
- I.d** Është larguar nga Rregullorja e Kuvendit me numër Npi-01/45 dt. 05.03.2026 Neni 10.2.27 në të cilin është thënë: “10.2.27 Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë).....5.00 €”

Pika 6

Pasqyrat Financiare për vitin 2025

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Hap diskutimin për këtë pikë. Fjalën ia jap z.Besnik Ahmetit.
z.Besnik Ahmeti, DBF: Përmes kësaj seance paraqes Raportin e Pasqyrave Vjetore Financiar për vitin 2025 duke u bazuar në Standartin Ndërkombëtare të Kontabilitetit të sektorit publik dhe Ligjin për menaxhimin e financave publike Ligji Nr. 04/L-116, Ligji Nr. 03/L-048, Ligji Nr. 04/L-194, Ligji Nr. 05/L-063 dhe Ligji Nr. 08/L-183. Në vazhdim lexoi materialin si në vijim (*shih dokumentin*).

z.Shefqet Krasniqi: Fillimisht, më lejoni që në emër të grupit të LDK-së t’ju falënderoj stafin për buxhet dhe financa për punën e bërë, z. Besnik Ahmeti dhe znj. Kimete Ukaj. Duke e njohur këtë fushë, e dimë se ajo kërkon saktësi dhe përkushtim. Pasqyrat financiare janë pasqyrë reale e gjendjes buxhetore dhe na tregojnë qartë se si janë mbledhur dhe menaxhuar mjetet publike. Te çështja e menaxhimit dhe shpërndarjes janë elementet kryesore që duhet të jenë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, ndërsa më e rëndësishmja është që shpërndarja të jetë në mënyrë të barabartë. Këtu një element thelbësor është planifikimi. Kur planifikimi bëhet pa analizë dhe pa kalkulime të sakta, ngatërrohen politikat fiskale. Në këtë pikë, LDK kërkon një planifikim të qartë, të mirë dhe të analizuar. Besoj që këtë përgjegjësi e keni pasur parasysh dhe keni qenë të përgatitur për këtë pjesë. Nuk do të ndalem më gjatë te kjo pikë dhe do t’u lë hapësirë kolegëve të mi që të shpalosin më në detaje çështjet përkatëse. Sa herë që bëhet fjalë për çështjen e parasë publike dhe të mirën e qytetarëve, ju garantojmë se ne si LDK jemi të gatshëm të japim kontributin tonë në mënyrë profesionale, sa herë që kërkohet nga ana juaj.

z.Muhamet Ademaj: Është mirë që buxheti është shpenzuar sipas plaifikimit, ne e mbështesim këtë raport.

z.Besnik Seferi: Për punët cilat janë bërë le t’i gëzojnë qytetarët dhe neve nuk na mbetet gjë tjetër veçse si grup i asamblesë t’a aprovojmë këto Pasqyra Financiare për vitin 2025.

z.Demokrat Mujota: Këto asfaltet rreth shtëpijave, a janë të përfshira sepse nuk ju ndëgjova që e cekët?

z.Asllan Beqaj: Qytetarët e kanë vlerësuar këtë punën e mirë dhe këtë raport.

znj.Arbresha Sylja: Në raport janë 4 rekomandime “të përsëritura”, dhe 5 tjera gjithsej 9. Si mundet Besnik ky raport me qenë “kaq i mirë”, por ju e dini shumë mirë çka do të thotë me ardhë një raport me kaq rekomandime.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Sa i përket rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit “të përsëritura” unë edhe kur kam raportuar për Raportin Vjetor të shpenzimeve, kam pas një pyetje që disa rekomandime a kemi me i përmbush ndonjëherë, kam thënë jo sepse kanë qenë të vitit 2016 dhe që është e pamundur me i gjetë lëndët. A ka rekomandime tjera që nuk janë përmbushur, po ka. Ka edhe tjera që po mundohemi me i përmbushur por janë “të përsëritura”. Me këto kapacitete që i kemi menaxherat e kontratave e kanë punë sekondare menaxhimin e kontratave dhe futjen e komplet raportit të punës së investimeve kapitale. Në prokurim nuk ka ndonjë “e gjetur” që është përsërit, fizikisht gjithë materialin e kam sepse materiali ka qenë voluminoz dhe ka qenë e pamundur me shti në sistem. Sa i përket rekomandimeve tjera të përsëritura është edhe një në tatimin në pronë, një rekomandim me pronat e nacionalitetit serbë që kanë obligime pa paguar. Nëse e dërgojmë në gjykatë nuk kemi edhe kë me e paditë. Sa i përket “asfaltëve” i keni ngatërruar drejtoritë, drejtohuni Drejtorisë së Urbanizimit, unë jam me ju njoftu çka paguhet, edhe si paguhet.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Konstatoj korumin prej 15 anëtarëve. Hedhë në votim Pasqyrat Financiare për vitin 2025.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 9 vota “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” miratoi, Pasqyrat Financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2025.**

Pika 7

Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komunës për periudhën 3 mujore Janar-Mars 2026

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Hapi diskutimin për këtë pikë, fjalën ia jap z.Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Përmes kësaj mbledhje paraqes Raportit Financiar të Komunës për periudhën 3 mujore Janar-Mars 2026, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për menaxhimin e financave publike Neni 58 dhe 45.4. Në vazhdim lexoi materialin si në vijim (*shih dokumentin*).

z.Muhamet Ademaj: E mbështes këtë Raport Financiar të Komunës për periudhën 3 mujore Janar-Mars 2026, poashtu e kam edhe një pyetje. Sa janë të hyrat për bizneset që shfrytëzojnë hapësirat publike?

znj.Fatlinda Rrafshi: Besoj që Raporti 3 mujor është dashtur të sillet sikurse Raporti Vjetor me kode ekonomike, sepse nuk po e dimë se sa janë bërë shpenzime për karburante të veturave zyrtare dhe sa janë paguar mjete shtesë për punë jashtë orarit.

z.Haqif Arifi: I përgëzoj drejtorin për Fianca për punën që e kanë bërë. Ne në vitin 2025 nuk e kemi përcjell dhe menaxhu punën në përgjithësi sepse nuk kemi qenë në asamble. Dua të ndalem në dy pika; ne si komunë jemi të varur nga Grantet Qeveritare, 93% nuk është mirë për ne sepse kemi varësi të madhe nga Qeveria, kemi rënie të hyrave vetanake në 3 mujorin e parë, ndërsa tatimin në pronë ka rënie shumë të madhe. Në anën tjetër shohim disa rritje pozitive si te lejet e ndërtimit dhe të hyrat nga arsimit. Te shpenzimet, nëse e krahasojmë struktura ku janë shpenzuar këto mjete le shumë për të dëshiruar sepse pjesa më e madhe shkon në paga dhe shtesa, d.m.th nuk shkon në zhvillim ose investime kapitale. Te investimet kapitale ka një realizim të ulët. Këto ishin disa vërejtje të mijat që besoj ju ndihmojnë, po ashtu kam edhe dy pyetje. Si e shpjegoni rënien e tatimit në pronë? Pse investimet kapitale kanë realizim kaq të ulët?

z.Asllan Beqaj: Kryesisht ky raport është në parametrat e rregullta sipas analizës time që e kam bërë ndërvite.

z.Besnik Ahmeti: Sa i përket përqindjes së ulët të shpenzimeve kapitale, këtë vit buxheti është alokuar në tri faza. Në fazën e parë ka qenë 1/12 e muajit Janar. Janë alokuar pagat dhe subvencionet, po flasim vetëm për 1/12. Të gjitha kategoritë janë alokuar, përveç investimeve kapitale. Njëjtë ka shku edhe muaji Shkurt, për shkakë të mos votimit të buxhetit në Qeveri. Pastaj për investimet kapitale ne e kemi aloku vet, sepse 1/12 e ka aloku automatikisht niveli qendror diku pas datës 10 mars. Për një periudhë të shkurtë unë konsideroj që invesimet kapitale janë shpenzuar mjaftueshem duke marrë parasysh duke e ruajtur buxhetin nga gjykata. Sa i përket rënies të tatimit në pronë, ju e dini që vitin e kaluar kanë hy edhe tokat bujqësore. Nuk mundemi me thënë që ka rënie sepse në vitin 2025 jemi 100.000 mijë euro. Këtë vitë është më i vogël sepse faturat e tatimit në pronë fillojnë me u shpërnda nga fundi i muajit Prill ose Maj.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Nëse nuk ka diskutime të tjera, po e hedh në votim këtë raport. Konstatoj kuorimin prej 15 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 12 vota “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim” miratoi, Raportin tre mujor Buxhetor të Komunës së Shtimes për periudhën 3 mujore Janar-Mars 2026.**

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Pasi që diskutime tjera nuk ka, atëherë po e përfundojë këtë mbledhje në ora 15:33h.

Procesmbajtëse

Sadbere Halili





Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi

